



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

Tiranë 17.01.2018

**Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT**

**Lënda: Raport i stafit të KKK-së mbi performancën e punës gjatë vitit 2017**

Gjatë vitit 2017 janë përmbushur pothuaj të gjitha detyrat e përcaktuara në planin vjetor të punës, miratuar nga Këshilli në mbledhjen e parë të vitit 2017. Por, përveç sa ishte parashikuar në planin e punës janë realizuar, përfunduar apo në proces, edhe detyra të tjera. Për të gjithçka sa i është ngarkuar stafit do të jepet ky informacion i hollësishëm si më poshtë vijon.

Statusi i përfundimit të detyrave të parashikuara për vitin 2017:

| <b>Nr</b> | <b>Detyrat e parashikuara për vitin 2017, miratuar nga KKK</b>   | <b>Statusi</b>        |
|-----------|--|-----------------------|
| 1         | Përkthimi për publikim i disa ushtrimeve mbi marrëveshjet koncesionare;  | Përfunduar            |
| 2         | Hartimi i udhëzuesit “Për plotësimin e PF të OJF-ve”;  | Përfunduar            |
| 3         | Draft projekti për ndryshimet e SKK-ve në kuadër të transpozimit të Direktivës (përfshirë bazën për konkluzione);                      | Përfunduar pjesërisht |
| 4         | Hartimi dhe publikimi i materialit jo të detyrueshëm për zbatim “Baza për konkluzione” që shoqëron SKK 15 të përmirësuar;              | Përfunduar            |
| 5         | Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri – Legjislacioni dhe rregullatori”, Universiteti i <b>Durrësit</b> ; | Përfunduar            |
| 6         | Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri – Legjislacioni dhe rregullatori”, Universiteti i <b>Shkodrës</b> ; | Shtyrë për vitin 2018 |
| 7         | Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri – Legjislacioni dhe rregullatori”, Universiteti i <b>Vlorës</b> ;   | Përfunduar            |
| 8         | Takim studentor “Kontabiliteti dhe raportimi financiar në Shqipëri –   | Përfunduar            |

|    |   |                       |
|----|---|-----------------------|
|    | Legjislacioni dhe rregullatori”, Unv <b>Elbasan</b> ;   |                       |
| 9  | Koordinimi i procesit të përkthimit dhe rishikimit të ndryshimeve të SNRF-ve, Azhornime 2017 dhe përgatitja e paketës për miratim nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë; | Përfunduar            |
| 10 | Përgatitja e variantit të konsoliduar të SNRF-ve në gjuhën shqipe (varianti 2017);  | Përfunduar            |
| 11 | Diskutimi i manualit të zbatimit të SKK 13 në kontabilitetin bujqësor (Bashkëpunim me stafin e Universitetit Bujqësor, Tiranë);   | Shtyrë për vitin 2018 |

Të tjera detyra të ngarkuara të papalanifikuara për vitin 2017:

| <b>Nr</b> | <b>Detyrat të pa- parashikuara për vitin 2017, miratuar nga KKK</b>  | <b>Statusi</b>   |
|-----------|--|------------------|
| 1         | Hartimi i paketës së ndryshimeve ligjore me burim Direktivën e BE ose nevojat për përditësim dhe përmirësim të ligjit 9228;  | Përfunduar       |
| 2         | Koordinimi dhe monitorimi i procesit të trajnimeve mbi SKK-të dhe SNRF-të, si pjesë e projektit të BB financuar nga SECO, ku përfitues janë anëtarët e shoqatave profesionale, inspektorët tatimorë dhe profesionistë të lirë të paatashuar në organizata; | Në proces        |
| 3         | Përfshirja si palë e interesuar në tryezat e organizuara nga QKB mbi formatin e publikueshëm të pasqyrave financiare;  | Përfunduar       |
| 4         | Angazhimi në GNP (Grupi Ndër-Institucional i Punës) për transpozimin e Legjislacionit të BE-së;  | Proces afatgjatë |
| 5         | Përgatitjet paraprake për Konferencën vjetore të KKK-së;   | Në proces        |
| 6         | Përgatitja dhe ndjekja e procedurave të daljes jashtë përdorimit të disa aktive mosfunksionale;  | Përfunduar       |
| 7         | Të tjera detyra në funksion të statusit dhe përgjegjësi të KKK-së;   | Sipas rastit     |

## **I. Materiale lidhur me marrëveshjet koncesionare**

Që në vitin 2016, Bordi ka marrë rregullisht në diskutim standardin 13, seksioni i marrëveshjeve koncesionare. Qëllimi i diskutimeve në Bord ka qenë lehtësimi i aplikimit të këtij seksioni të ri dhe në një prej mbledhjeve stafit i'u caktua detyra të mbledhë informacione zyrtare mbi kontrata koncesionare, shtrirjen e tyre, zbatueshmërinë e tyre, kontabilitetin e zbatueshëm rast pas rasti, etj.

Si hap të parë stafi mori takim me disa zyra të shtetit (Min Fin, Min Ek, Min Energji) me qëllim prezantimin e interesimit të KKK për çështjen e koncesioneve dhe më pas sigurimin e informacioneve të nevojshme.

Ajo që stafi fillimisht kërkoi informacion për t'ia vënë Bordit në dispozicion ishte një statistikë për shifrat e afarizmit dhe numrin e të punësuarve në njësitë ekonomike koncesionmarrëse. Ky informacion do të shërbente për të kuptuar sa njësi koncesionare zbatojnë SKK 13 në raportimin financiar të tyre. Ky informacion në një fare mënyre do të përcaktonte rëndësinë e hartimit të një udhëzuesi në shqip për aplikimin e seksionit të marrëveshjeve koncesionare. Ky informacion nuk ishte i disponueshëm për faktin se regjistri i kontratave koncesionare nuk ishte i populluar. Nuk kishte një informacion mbi numrin e kontratave koncesionare të lidhura mes shtetit shqiptar dhe operatorëve ekonomik privat. Ky informacion duhej mbledhur tek secili autoritet kontraktor.

Më pas stafi, pranë ANTRAKO, kërkoi informacion mbi sektorët ku ishin aktive kontratat koncesionare ekzistuese. Informacioni i siguruar mbulonte një pjesë të vogël të kontratave pasi informacioni që ato dispononin ishte shumë i limituar. Për kampionin e siguruar rezultoi se mbi 85% e kontratave koncesionare ishin në fushën e energjitikës.

Hapi i tretë ishte kontaktimi nga stafi i KKK të zyrës së GIZ me qëllim sigurimin e mbështetjes me konsulencë gjatë hartimit të një manuali për raportimin financiar të marrëveshjeve koncesionare. Korespondenca me GIZ është aktive. Ata kërkojnë formalizimin e kërkesës duke sqaruar qartë termat e referencës së kontratës me konsulentin.

Por, pas disa mbledhjesh në Bord, vendimi më i fundit ishte që stafi të përkthente disa materiale mbi kontabilitetin në marrëveshjet koncesionare dhe me një vlerësim të dytë të shikohej mundësia e hartimit të një manuali.

Stafi ka përfunduar përkthimin e disa materialeve të siguruara nga z. Binaj, anëtar i grupit të punës për koncesionit, brenda KKK-së. Materialet e përkthyer i kaluan Bordit për vlerësim dhe më pas u publikuan në faqen zyrtare të KKK-së.

Gjithashtu në kuadër të përpjekjeve për hartimin e një manuali për zbatimin e SKK 13 seksioni i marrëveshjeve koncesionare, stafi bëri disa takime me përfaqësues të disa kompanive shqiptare që kanë lidhur kontrata koncesionare. Nga takimet rezultoi se vetëm një kompani "Kastrati Group" ishte në kushtet e zbatimit të kontabilitetit për koncesionet dhe zbatonte korrektësisht IFRIC 12. Kjo kompani i'u përgjigj pozitivisht ftesës për të ndërtuar së bashku me stafin e KKK-së një shembull (ushtrim ilustrues) të aplikimit të IFRIC 12 në sektorin e shërbimit të rrugëve.

## **II. Draft udhëzuesi për zbatimin e SKK për OJF**

SKK për OJF me Urdhër të Ministrit të Financave Nr. 62 datë 17.09.2015 u shpall i detyrueshëm për zbatim prej Janarit 2016. Gjatë 2016 stafi i KKK-së u angazhua në tryeza të rumbullakëta dhe ëorkshop-e të ndryshme për të përcjellë standardin tek përdoruesit, por ky

proces preku një numër shumë të limituar të tyre. Stafi në fillim të 2017 filloi punën për hartimin e udhëzuesit të Standardit por më pas me përfshirjen e KKK-së në projektin e ËB u vendos që udhëzuesi të ishte një nga produktet e projektit. Konsulentit i'u vu në dispozicion nga stafi standardi (i përkthyer nga stafi në gjuhën angleze, së bashku me pasqyrat).

Varianti i parë i udhëzuesit i'u dorëzua stafit në fillim të muajit Prill. Stafi e konsideroi atë të paplotë dhe e ridërgoi për plotësime shtesë me shembuj teorik dhe praktik.

Varianti i përmirësuar mbërriti në fillim të muajit maj. Variantin e dytë stafi e kaloi për diskutim në Bord dhe gjithashtu e shpërndaui në mënyrë elektronike në një grup të vogël profesionistësh.

Pas sugjerimeve të Bordit dhe vërejtjeve të profesionistëve jashtë KKK-së, stafi i kërkoi një takim konsulentit të ËB dhe i vuri në dispozicion të përkthyer të gjitha komentet dhe vërejtjet e bëra. Takimi u zhvillua në datë 15 qershor. Konsulenti pranoi kthimin mbrapsht të udhëzuesit dhe u angazhua që të punojë për plotësimet përkatëse.

Në fund të muajit shtator konsulenti e ridërgoi udhëzuesin me plotësimet e nevojshme. Stafi pasi përktheu materialin e kaloi në Bord për miratim. Pas miratimit në mbledhjen e radhës, materiali u publikua në faqen zyrtare të KKK-së.

### **III. Ndryshimet e SKK-ve për reflektimin e Dir 34/2013 të EU**

Në kuadër të transpozimit të Direktivës 34/2013 të EU për kontabilitetin u krijua tabela e përputhshmërisë nga stafi i BB. Nga tabela rezultuan një numër i konsiderueshëm diferencash për të cilat u morën vendimet si më poshtë:

- Një pjesë e tyre të reflektoheshin në ligjin për kontabilitetin
- Një pjesë e tyre të reflektoheshin në standardet kombëtare
- Një pjesë të vlerësoheshin në një periudhë të mëvonshme

Përsa i përket ndryshimeve në standardet kombëtare, ndryshimet prekën SKK 2 dhe SKK 9. Ndryshimet kanë kaluar në mbledhjet përkatëse të KKK-së dhe kanë marrë aprovimin.

### **IV. SKK15 e përmirësuar, Pjesa B “Baza për konkluzione”**

Sipas strategjisë së miratuar nga KKK, standardet kombëtare të kontabilitetit do të jenë të ndara në dy pjesë. Pjesa (A) do të jetë pjesa e detyrueshme për zbatim e standardit dhe do të përmbajë të gjitha kërkesat e tij ndërsa pjesa (B) do të jetë jo e detyrueshme për zbatim dhe do të ketë seksionin e bazës për konkluzione ku jepen të gjitha arsyet dhe argumentet për ndryshimet që pëson standardi në vite si dhe seksioni i udhëzuesit për zbatim, i mbushur me ilustrime teorike dhe praktike.

Gjatë vitit 2016, stafi punoi për ndryshimet e SKK 15 duke ndjekur qasjen e ndryshimeve të 14 SKK-ve të tjera. Pas miratimit në Bord, me Urdhër të Ministrit të Financave, Nr 78 datë 12.07.2016, SKK 15 e përmirësuar (Pjesa A) u shpall e detyrueshme për zbatim prej Janarit 2017.

Pjesa B e standardit ishte një angazhim i stafit për vitin 2017. Për pjesën B stafi punoi vetëm për bazën për konkluzione pasi udhëzuesi nuk do të ishte i nevojshëm duke konsideruar thjeshtësinë e kërkesave të SKK 15.

*Baza për konkluzione*, fillimisht jep një tabelë krahasueshmërie mes standardit të mëparshëm dhe atij të përmirësuar në mënyrë që publiku i interesuar të kuptojë shpejt dhe pa keqinterpretime

të gjitha ndryshimet e ndodhura dhe efektet që vijnë prej tyre. Më pas materiali vazhdon me tabelën tip, siç është ndërtuar dhe në 14 SKK-të e tjera, ku çdo paragraf i ndryshuar evidentohet më vete i shoqëruar me komente për ndryshimin e bërë dhe argumentin përkatës.

Baza për konkluzione pas miratimit në Bord u publikua në faqen e internetit të KKK-së dhe është e aksesueshme për publikun në format PDF.

## **V. Takimet Studentore në rrethe**

Sipas planifikimit u organizuan në rrethe takimet studentore. Rrethet e mbuluara janë Durrësi, Vlora dhe Elbasani. U shty takimi në Shkodër, planifikuar në dhjetor 2017, për shkak të kushteve të këqija të motit. Takimet u zhvilluan me axhendën si më poshtë:

- ✚ Edukimi universitar dhe mundësitë që të ofron edukimi kontabël:
  - Karriera profesionale (MP dhe vazhdon KM dhe Auditues)
  - Karriera akademike (MSH dhe vazhdon Dr, Prof As dhe Prof)
  
- ✚ Karriera profesionale, legjislatiioni dhe asociimi
  - Direktiva, ligji, disa VKM
  - Rregullatori, statusi-rol-i-detyrat
  - Aderimi, shoqatat dhe institutet
  
- ✚ Kërkesat për një filluar dhe vazhduar një karrierë profesionale të suksesshme
  - Ligji për rregullimin e profesionit
  - Kërkesat për KM
  - Kërkesat për auditues

Për të mbuluar informacionin në pjesën e tretë të prezantimit, në rrethin e Durrësit stafi ftoi në takim Drejtorin Ekzekutiv të IEKA-s, zj.Elvira Hoxha. Ndërsa në dy rrethet e tjera për shkak të angazhimeve të bashkëpunëtorëve stafi nuk u shoqërua nga të tjerë.

Pjesëmarrës në takime kanë qenë studentë të viti të tretë, cikli bachelor dhe studentë të nivelit master. Profesoratet kanë mirëpritur përfaqësuesit e KKK dhe takimet janë mbyllur dorëzimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Është firmosur marrëveshja në rrethin e Durrësit dhe Vlorës, jemi në pritje të kopjes së firmosur në rrethin e Elbasanit. Takimi në Shkodër është planifikuar për muajin mars 2018.

## **VI. Azhornimet e materialeve të ardhura nga IASB në vitin 2017**

Gjatë vitit 2017 IASB ka dërguar disa materiale për azhornimet e vitit 2017 të cilat janë pjesë e versionit të konsoliduar 2017.

Azhornimet e mbërritura deri tani janë si në vijim:

| <i>Titulli</i>        | <i>datë efektive</i> |
|-----------------------|----------------------|
| Ndryshime të SNK 12   | 1 janar 2017         |
| Ndryshime të SNK 7    | 1 janar 2017         |
| Ndryshime të SNRF 15  | 1 janar 2018         |
| Ndryshime të SNRF 2   | 1 janar 2018         |
| Ndryshime të SNRF 4   | 1 janar 2018         |
| Ndryshime të SNRF 2   | 1 janar 2018         |
| Ndryshime të SNK 40   | 1 janar 2018         |
| Ndryshime të KIRFN 22 | 1 janar 2018         |

Materiali u kalua për përkthim, i cili mbaroi në prill 2017. Më pas materiali i kaloi rishikuesve për rishikim. Materialet e përkthyer dhe të rishikuara, pas miratimit nga Bordi i KKK-së u dërguan për shpallje pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Shpallja e tyre u bë me Urdhrin nr 120, datë 06.11.2017. Aktualisht ato janë publikuar në faqen zyrtare të KKK-së.

Pas shpalljes së tyre nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, stafi u angazhua në përgatitjen e variantit të konsoliduar (2017). Ky variant u dërgua pranë IASB dhe kaloi testin e cilësisë. IASB publikoi në ëbsiten zyrtar të saj standardet e konsoliduara 2017 në gjuhën shipe.

## **VII. Përgatitja e një udhëzuesi / komentari për aplikimin e SKK 13 në kontabilitetin bujqësor**

Për përgatitjen e komentarit ishin planifikuar të ftoheshin bashkëpunëtorë jashtë KKK-së si profesionistë me eksperiencë në zbatimin e kërkesave të kontabilitetit në sektorin e bujqësisë. Për pamundësinë e përfshirjes gjatë 2017 të ndonjë bashkëpunëtori, ky projekt i KKK-së është shtyrë për vitin 2018.

### **Detyra të tjera jashtë parashikimit për vitin 2017**

#### **a) Draft ligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"**

Stafi i KKK në bashkëpunim me juristin e dërguar nga WB punoi për disa muaj me ndryshimet ligjore të ligjit për kontabilitetin. Ndryshimet e kishin burimin tek:

1. Propozimet e anëtarëve të KKK duke reflektuar problematikat e konstatuara në vite;
2. Kërkesat e Dir 34/2013/EU;
3. Propozimet e EB dhe Ministrisë së Financave;
4. Komentet e palëve të interesit;

*Për informacion*

Nga Dir 34/2013 janë bërë pjesë e ligjit nenet si më poshtë:

| <b>Direktiva 34/2013/EU</b>                        | <b>Ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”</b> |
|--|---|
| Neni 2, pika 2                                     | Neni 3, pika 13   |
| Neni 2, pika 15                                    | Neni 3, pika 10   |
| Neni 3, pika 1-7,                                  | Neni 4, pika 1 dhe 2                                      |
| Neni 3, pika 10                                    | Neni 4, pika 4  |
| Neni 3, pika 13                                    | Neni 4, pika 5  |
| Neni 4, pika 1                                     | Neni 13, pika 1   |
| Neni 9, pika 7 (c)                                 | Neni 14, pika 2   |
| Neni 12, pika 11                                   | Neni 14, pika 1   |
| Neni 14, pika 1                                    | Neni 13, pika 4   |
| Neni 16, pika 1 (h)                                | Neni 16, pika 2   |
| Neni 17, pika 1 (d)                                | Neni 16, pika 3 (a)                                       |
| Neni 17, pika 1 (e)                                | Neni 16, pika 3 (b)                                       |
| Neni 17, pika 1 (g) pjesërisht dhe Neni 17, pika 2 | Neni 16, pika 3 (c)                                       |
| Neni 17, pika 1 (j)                                | Neni 16, pika 3 (ç)                                       |
| Neni 17, pika 1 (k)                                | Neni 16, pika 3 (d)                                       |
| Neni 17, pika 1 (l)                                | Neni 16, pika 3 (dh)                                      |
| Neni 17, pika 1 (m)                                | Neni 16, pika 3 (e)                                       |
| Neni 17, pika 1 (n)                                | Neni 16, pika 3 (ë)                                       |
| Neni 18, pika 1 (b)                                | Neni 16, pika 4   |
| Neni 19, pika 1                                    | Neni 17, pika 1   |
| Neni 19, pika 2 (a-e)                              | Neni 17, pika 2   |
| Neni 19, pika 3                                    | Neni 17, pika 3   |
| Neni 19a, pika 1                                   | Neni 18, pika 4   |
| Neni 19a, pika 5                                   | Neni 18, pika 5   |
| Neni 20, pika 1(a)                                 | Neni 19, pika 1 (a)                                       |
| Neni 20, pika 1(b)                                 | Neni 19, pika 2   |
| Neni 20, pika 1(c)                                 | Neni 19, pika 1 (b)                                       |
| Neni 20, pika 1(f)                                 | Neni 19, pika 1 (c)                                       |
| Neni 20, pika 1(g)                                 | Neni 19, pika 1 (ç)                                       |
| Neni 20, pika 2                                    | Neni 19, pika 4   |
| Neni 20, pika 5                                    | Neni 19, pika 3   |
| Neni 22, pika 1 (a)                                | Neni 20, pika 1   |
| Neni 22, pika 6                                    | Neni 12, pika 3   |
| Neni 23, pika 1                                    | Neni 12, pika 2   |
| Neni 29, pika 1                                    | Neni 20, pika 1   |
| Neni 29, pika 2                                    | Neni 20, pika 1   |
| Neni 29a, pika 1                                   | Neni 18, pika 1, 2 dhe 3                                  |
| Neni 29a, pika 3                                   | Neni 18, pika 4   |
| Neni 29a, pika 5                                   | Neni 18, pika 5   |
| Neni 30, pika 1                                    | Neni 20 pjesërisht  |

|                     |                 |
|---------------------|-----------------|
| Neni 36, pika 1 (c) | Neni 17, pika 3 |
| Neni 36, pika 7     | Neni 13, pika 4 |

## VIII. DETYRA TË TJERA

### a) Pyetësi për vetvlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2016

Nga ana e stafit të KKK plotësohet çdo vit pyetësi i vetvlerësimit i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin paraardhës. Ky pyetësor dërgohet çdo vit nga Ministria e Financës (është i disponueshëm dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financës) dhe është i detyrueshëm për t'u dorëzuar çdo datë 1 Mars.

Ky dokument tregon përgjegjësitë kryesore të Nëpunësit Autorizues në kuadrin e implementimit të konceptit të përgjithshëm menaxherial. Me anë të tij bëhet vetvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda institucionit.

Ky pyetësor ka pesë komponentë:

- 1.Mjedisi i kontrollit
- 2.Menaxhimi i riskut
- 3.Aktivitetet e kontrollit
- 4.Informimi dhe komunikimi
- 5.Monitorimi

### b) Deklarata dhe raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017

Pas plotësimit të pyetësit të mësipërm Nëpunësi autorizues hartoi dhe deklaraten e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për institucionin.

Nëpunësi autorizues deklaron përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jofinanciare të njësisë, monitorimin që i ka bërë sistemit të kontrollit të brendshëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit gjatë vitit raportues 2016 duke krijuar një mjedis kontrolli, menaxhimi të riskut, veprimtarisë së kontrollit, nëpërmjet marrjes së informacioneve dhe komunikimeve të vazhdueshme me vartësit, nëpërmjet vlerësimeve dhe analizave në vazhdimësi, nëpërmjet vendosjes së një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme të njësisë.

### c) Faqja e internetit – programi i transparencës

Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, stafi përditëson programin e transparencës me frekuenca tre mujore. Publikohen në faqen e internetit regjistri i prokurimeve



(parashikimi dhe fakti) si dhe shpenzimet buxhetore. Në linkun e posaçëm publikohen edhe vendimet e rëndësishme të Bordit. Për vitin 2017 gjithçka është publikuar sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar.

#### **d) Kthim përgjigje subjekteve**

Tashmë është një rutinë normale pune që subjekte të ndryshme i drejtohen me shkresë ose me email stafit të KKK për interpretime apo sqarime lidhur me standardet apo udhëzuesin në zbatim të tyre. Përgjigjet, shkresore apo përmes emailit publikohen më pas në faqen zyrtare me qëllim që t'u shërbejnë dhe njësisive të tjera që mund të hasin të njëjtat paqartësi në punën e tyre.

#### **e) Procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në KKK**

Stafi gjatë kësaj periudhe është angazhuar në lidhje me nxjerrjen jashtë përdorimit të disa AAM-ve të zyrave tona.

KKK dispononte në zërin e Aktiveve të Trupëzuara disa pajisje informatike dhe pajisje zyre (kompjuterë, printera dhe kondicionerë) të cilët nuk ishin më në gjendje pune për shkak të vjetërimit të tyre. Këto pajisje ishin blerë në vitin 2007 dhe janë shfrytëzuar në kapacitetin e tyre maksimal.

Gjithashtu, në vitin 2007 është botuar teksti profesional “SKK-të, ushtrime dhe shpjegime”. Ky tekst ka dalë nga qarkullimi pasi nuk është më në përputhje dhe në zbatim të SKK-ve të përmirësuara, shpallur të detyrueshme për zbatim me Urdhër nr 64, datë 22/07/2014. Për këtë arsye, sasia e mbetur gjendje (pashitur), 485 kopje, duhej hequr nga vlera e inventarëve gjendje.

Procesi i nxjerrjes së aktiveve jashtë përdorimit u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Financës. Janë ngritur disa komisione në lidhje me këtë procedurë; komisioni i vlerësimit të aktiveve, komisioni i miratimit për daljet jashtë përdorimit si dhe komisioni i asgjësimit të aktiveve jashtë përdorimit. Mbështetur në Udhëzimin nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” KKK i'u drejtua Ministrisë së Financave për ngritjen e të gjitha komisioneve më sipër pasi KKK nuk ka burimet njerzore të nevojshme, referuar numrit të vogël të stafit si dhe faktit që nuk ka staf IT për të bërë vlerësimin e gjendjes së pajisjeve informatike që kërkohet të bëhen dalje jashtë përdorimit.

Në fillim të muajit dhjetor, përfaqësues të Ministrisë së Financave së bashku me përfaqësues të kompanisë së riciklimit mundësuan largimin fizik të aktiveve jashtë përdorimit dhe më pas depozituan për procedurë dokumentet e nevojshme si barrë prove për asgjësimin korrekt të tyre.

*Stafi i KKK-së, Tiranë 17.01.2018*